



## E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 13.01.2023, duke filluar në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Arton Brahimi, Elmira Nikçi - Rexha, Oktay Kurtesh, Trieria Kasumi - Berisha, Adnan Ajeti, Kimeta Shok, Faton Marrolli.

**Mungoi:** Nenad Miladinovic.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Betim Abdullahu, u.d udhëheqës i ZKKK-së, Klaudia Mula, koordinatorë për komunitete në ZKKK-së, Arianita Beqa- Rraci, zyrtare nga UNMIK, Diellza Azemi, zyrtare nga UNMIK-u,, Alesandro Marino, përfaqësues nga KFOR-i.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete znj. Mirsada Behluli me këtë

## R E N D T Ë D I T Ë S

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Analiza e punës së Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2022 dhe aktivitetëve të Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
3. Ftesë për kryetarin e Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama;
4. Shqyrtimi i kërkesave për ndihmë për të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për kremtimin e festave kombëtare;
5. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave për çdo muaj sipas rëndësisë prioritare;
6. Raporti i ZKKK-së, për muajin dhjetor 2022;
7. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë për sigurinë dhe gjendjen në komunitetet e tyre;
8. Të ndryshme.

## **Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së**

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

## **Pika e dytë**

**Analiza e punës së Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2022 dhe aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.**

**Mirsada Behluli**, kryesuese sa i përket kësaj pike të rendit të ditës të pranishmit i informoi se Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2022, ka mbajtur gjashtë mbledhje pasi që konstituimi i Komitetit për Komunitete është vonuar, pastaj muaji gusht ka qenë muaji i pushimit, në muaji shtator kanë qenë grevat. Ajo të pranishmit i informoi lidhur me punën dhe aktivitetin e Komitetit gjatë vitit 2022, ku thotë se, Komiteti ka pasur takime me drejtorët e drejtorive, si p.sh me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ku janë prezantuar problemet tona pra të komuniteteve jo shumicë sa i përket shërbimeve publike.

Është mbajtur takimi me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, ku kemi diskutuar lidhur me ndihmën për familjet me nevojë, dhe ndihmën për dru zjarri, ashtu që përmes ZKKK-së, kemi arritur t'i gëzojmë 175 familje me shumë monetare për dru zjarri.

Është mbajtur takimi me drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit znj. Besianë Musmurati, të cilën e kemi njoftuar me problemet dhe nevojat në fushën e arsimit për komunitetet jo shumicë.

Kemi formuar komisionin për vizita në shkollat ku vijojnë mësimin fëmijët e komuniteteve jo shumicë e cila është realizuar prej d.t. 13 - 18 tetor.

Janë vizituar tetë shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë rreth 312 nxënës ku jemi njoftuar me sistemin arsimor për komunitetin jo shumicë dhe i kemi identifikuar nevojat dhe problemet e tyre.

Është bërë aplikimi për investimet kapitale nga komuniteti serb për Bërnice të Poshtme, që ka të bëjë me rregullimin e rrugës prej 2.5 kilometra.

Projekti i dytë ka qenë kyçja e ujit në ujësjellësin rajonal fjala është për fshatin Slivovë, si dhe me shumë punë dhe aktivitete tjera.

## **Pika e tretë**

**Ftesë për Kryetarin e Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama**

Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për njëzëri nga mbledhjet e ardhshme.

## **Pika e katërt**

**Shqyrtimi i kërkesave për ndihmë për të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për kremtimin e festave kombëtare**

**Betim Abdullahu**, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se ne sikurse çdo vit në bazë të planit të punës që e kemi, i kemi përgatitur dhe i kemi gati çdo datë, çdo festë që ka të bëjë me komunitetet që jetojnë në Komunën e Prishtinës, si dhe kemi me iu drejtuar secilës drejtori

përkatëse që merret realisht me subvencionim ose mbështetjen për ditët e festës. Pra e dini edhe ju se nganjëherë mundem me dështuar për shkak se nuk është në kompetencën tonë.

Ai në vazhdim tha se sa i përket punës tonë ne veç se i kemi gati mirëpo a kanë me u realizuar ato kërkesa qysh janë planifikuar nga secili komunitet atë nuk mundem me ju thënë sot se nuk e di sepse nuk varet nga ne edhe herëve të tjera janë realizuar ndoshta por jo qysh kanë planifikuar komunitetet.

Tani ia jap fjalën koleges Klaudia e cila do të ju informoj më në detaje pasi që është marr me çështjen e kërkesave dhe ankesave.

**Klaudia Mula**, duke u ndërlidhur në diskutim tha se unë vetëm kisha me e plotësuar këtë pjesë, pra duke e shikuar buxhetin e planifikuar në dhjetor 2023 të Komunës së Prishtinës, në Drejtorinë e Kulturës, parashihet edhe manifestimi i festave kombëtare të komuniteteve.

Duke u bazuar në këtë ne si zyre i kemi dërguar shkresë Drejtorisë së Kulturës, si dhe është i njoftuar edhe kryetari dhe nënkryetari, që t'i kenë parasysh kërkesat që vijnë nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë lidhur me manifestimin e festave kombëtare.

Kështu që unë kisha propozuar që përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë t'i paraqesin sa më shpejt kërkesat e tyre në Drejtorinë e Kulturës, në bazë qysh këta i planifikojnë që t'i festojnë ato festat kombëtare, në mënyrë që të ju jepet hapësirë edhe drejtorisë që të e shqyrtojnë kërkesat që mos të kenë telashe në ditën e manifestimit.

Gjithashtu është mirë të informojmë Drejtorinë e Kulturës, se për çka është përkrahja se po ka kërkesa të ndryshme kokteje, në restorante e ato nuk e di se sa munden me i përkrah, kështu që unë e di se janë vetëm aktivitete kulturore.

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se të gjithë ata që dëshirojnë kremtimin e ditës së festave kombëtare të paraqesin kërkesën në Drejtorinë e Kulturës dhe të aplikojnë.

**Betim Abdullahu**, duke u ndërlidhur në diskutim tha se Fatoni është i pari i cili duhet me bërë kërkesën pasi që 15 shkurt është dita kombëtare e komunitetit ashkali, pasi që me 8 prill është dita kombëtare e komunitetit rom. Kështu që do të ishte mirë që çfarë do që keni planifikim apo si ju e mendoni një kremtim feste me e shtruar kërkesën në Drejtorinë e Kulturës.

Ai në vazhdim duke iu drejtuar z. Ajeti lidhur me ndihmën rreth kërkesës tha se mund t'i drejtohet ZKKK-së dhe tash çka kemi mundur me bërë qysh kemi me dërguar ajo është çështje tjetër.

**Kimeta Shok**, shtroi pyetje se çfarë do të ishte ndihma nga ZKKK-ja, për kremtimin e ditës kombëtare të komuniteteve.

**Betim Abdullahu**, duke iu përgjigjur znj. Shok lidhur me pyetjen e shtruar tha se krejt projektet tona që janë të realizuara p.sh çdo vit projekti për dru zjarri, projektet për pako higjienike, pako ushqimore, për materiale shkollore për fëmijë, për dhurata për fëmijë të fund vitit të gjitha janë projekte të mbështetura prej drejtorive përkatëse.

Ne si zyre nuk kemi buxhet të veçantë të ndarë për subvencione ose për kategori të ndryshme.

**Kimeta Shok**, tha se unë po pyes konkretisht për ditën e kremtimit.

**Betim Abdullahu**, tha se edhe më parë ne nuk kemi buxhet të veçantë për kremtimin e festave ose pavarësisht për çfarë do projekti tjetër.  
Pra të gjitha projektet të cilat janë realizuar janë realizuar përmes drejtorive përkatëse.

**Pika e pestë**

**Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave për çdo muaj sipas rëndësisë prioritare**

**Mirsada Behluli**, kryesuese shtroi pyetje për zyrën për komunitete se në vitin 2022, a keni pasur kërkesa apo ankesa.

**Betim Abdullahu**, duke iu përgjigjur znj. Behluli tha se tri projekte të cilat u përmendën në rekapitullimin e punës një vjeçare nga ana e juaj, unë vetëm për njoftim dua të ju them se trotuari në Bërnice veç është në projekt e sipër d.m.th i kanë përfunduar krejt procedurat. Gjithashtu ujësjellësi në fshatin Slivovë ka kaluar ku tenderin e ka fituar një kompani, por tash është koha e dimrit që realisht këto projekte që janë për gropime shtyhen deri në muajin shkurt apo mars varet prej kohës se si ka me qëndruar.

Parku në lagjen e komunitetit ashkali në Vranjevc, vetëm se ka filluar një pjesë është fituar projekti që e kemi dërguar në Zyrën e Kryeministrit, për çështje të komuniteteve, është pranuar dhe na kanë njoftuar. Sa i përket ujësjellësit në fshatin Slivovë, veç se janë përfunduar të gjitha procedurat ku ka fituar një kompani e cila realizimin e projektit ka me e filluar në pranverë.

Ndërsa sa i përket parkut në lagjen e ashkalive në Vranjevc, d.m.th një pjesë edhe Drejtoria e Investimeve Kapitale, por edhe Zyra për Komunitete pranë Kryeministrit në njëfarë forme d.m.th e kemi mbështetjen prej të dyja anëve dhe e kanë informuar kryetarin që e kemi fituar si projekt.

Mënyrën e financimit e organizojnë Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Zyra për Komunitete pranë Kryeministrit.

Ndërsa sa i përket kërkesave interne, kërkesave të vogla rekomandimeve që mi keni dërguar janë kërkesa që i përkasin p.sh nesër munden mos me punuar tri drita në një lagje pavarësisht se ku jetojnë komunitetet ose ndonjë prishje tjetër e vogël këto i bëni në qendrën për shërbime me qytetarë dhe na njoftoni që keni bërë kërkesë.

**Klaudia Mula**, tha sa për sqarim sa i përket investimeve kapitale shkon përmes zyrës për komunitete.

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se secili prej nesh duhet të bëjë kërkesë për komunitetin të cilit i përkasin p.sh për shërbimet publike t'i dërgojmë ose përmes emailit ose përmes zyrës për qytetarë.

**Betim Abdullahu**, tha se për të mos keqkuptuar projektet e mëdha të investimeve kapitale i dërgojmë si çdo vit me kërkesa të juaja përmes zyrës tonë.

**Elmira Nikçi - Rexha**, tha se nuk është kompetencë e ZKKK-së, me i adresuar ankesat në baza ditore, por kompetenca e ZKKK-së, është dorëzimi i kërkesave për investimet kapitale dhe të shtyn projekte më të mëdha.

**Klaudia Mula**, tha se ne si zyre i kemi bërë shkresë të gjitha drejtorive që t'i marrin parasysh kërkesat e përfaqësuesve që vijnë nga komunitetet.

Pas shumë diskutimesh dhe propozimesh anëtarët e Komitetit për Komunitete në krye me znj. Mirsada Behluli, erdhën në konkludim që sa i përket kërkesave interne, kërkesave të vogla çdo përfaqësues i komuniteteve të bëjë kërkesë personalisht për komunitetin e vet në qendrën për qytetarë në Komunën e Prishtinës.

#### **Pika e gjashtë**

##### **Raporti i ZKKK-së, për muajin dhjetor 2022**

**Betim Abdullahu**, tha se nuk kisha me u ndalur shumë tek raporti i dhjetorit pasi që veç i folëm projektet të cilat janë realizuar si p.sh dhuratat e fëmijëve për fund vit, pakot ushqimore, pako higjienike, shpërndarja e druve për zjarr e shumë aktiviteteve tjera. Besoj se secili prej jush e keni marr raportin, ndërsa raportin vjetor do ta keni në mbledhjen e ardhshme ku do t'i keni të cekura të gjitha punët, aktivitetet e kryera që nga kërkesat e juaja e deri tek puna e ZKKK-së, gjatë vitit 2022.

**Faton Marolli**, tha se dua të shtoj diçka por nuk ka shkuar përmes ZKKK-së, por vetëm e kam njoftuar ZKKK-në, se gjatë muajit dhjetor si përfaqësues kam bërë kërkesë në Zyrën e UNMIK-t, dhe i kemi marr 35 çanta për fëmijë së bashku materialin shpenzues d.m.th fletore, lapsa etj.

#### **Pika e shtatë**

##### **Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë për sigurinë dhe gjendjen në komunitetet e tyre**

**Adnan Ajeti**, dua me ju falënderuar për pakot që më janë shpërndarë si ato ushqimore ashtu edhe higjienike.

**Betim Abdullahu**, tha se kemi pasur vonesa në realizimin e projekteve për arsye të ndryshimeve të çmimit brenda vitit 2022, 2 apo 3, herë kanë fituar kompanitë e pastaj janë tërhequr ku ne detyrimisht është dashur me pritë për shkak se procedurat e prokurimit janë ashtu.

#### **Pika e tetë**

##### **Të ndryshme**

**Arianita Beqa - Rraci**, përfaqësuese nga UNMIK-u, shtroi pyetje këto punët e mira që po i bëjnë ZKKK-të, me komunitetet a paraqiten diku në media sociale, sepse mendoj se është një punë e mirë dhe është mirë diku me u prezantuar përmes zyrtarëve të juaj për media. Ajo në vazhdim tha se unë i përcjelli të gjitha komunat ku ata të gjithë i prezantojnë çoftë për komunitetet, çoftë për qytetarët.

**Betim Abdullahu**, tha se ne si zyre jo që nuk kemi mundur me i bërë ndonjë fotografi kur i kemi shpërndarë ndonjë pako e kemi parë si turp apo si lëmosh, nuk është ide e keqe është ide e mirë por ne nuk e kemi praktikuar. Meqë ne raportojmë për çdo gjë.

**Triera Kasumi - Berisha**, tha se në një rën prej mbledhjeve unë e kam bërë një kërkesë brenda komitetit që me e pasur një faqe në facebook, pasi që për mendimin tim ne nuk jemi shumë afër me të gjitha komunitetet, mendoj se ata nuk janë të informuar ose përfaqësuesit e tyre që janë në Komitet nuk i informojnë.

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se edhe unë kam propozuar diçka të tillë por ka pasur reagim nga z. Nenad.

Ajo në vazhdim tha se duhet të konsultohemi me zyrën ligjore se si mund të veprojmë.

**Elmira Nikçi - Rexha**, tha se është faqja zyrtare e Komunës dhe aty mundeni të informoheni për të gjitha, vetëm ne si komitet duhet me marr iniciativë ju pikërisht si kryesuese që çka do që keni ju me publikuar apo çfarë do projekti e njoftoni ZKKK-në, e pastaj ajo e delegon për publikim.

**Arianita Beqa - Rraci**, përfaqësuese nga UNMIK-u, tha se zyra e UNMIK-t, shumë shpejt d.m.th gjatë shkurtit do ta ketë një thirrje për financim të projekteve ku mundën të aplikojnë OJQ-të, si dhe institucionet lokale dhe qendrore.

Pas shumë diskutimesh sugjerimesh dhe propozimesh Komiteti për Komunitete nxjerri këto

### K O N K L U Z I O N E:

1. Të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë të jenë në nivel më të lartë të detyrës dhe të punojnë më shumë për komunitetet e tyre;
2. Secili përfaqësues i komunitetit jo shumicë t'i përcjellë kërkesat me shkrim përmes emailit drejtorive përkatëse, siç janë kërkesat e përmendura nga takimi i kaluar;
3. Secili përfaqësues i komuniteteve jo shumicë t'i përcjellë Drejtorisë për Kulturë një shkresë me shkrim ose me email njoftimin për shënimin e festave kombëtare;
4. Për mbledhjen e radhës të ftohen zyrtarët e departamentit për komunitete të MKK-së,
  - a) Subvencionet e MKK-së;
  - b) Propozimi i ndihmës tjetër për komunitetet jo shumicë;
5. Ndihma përmes Komunës për subvencione, biznes privat dhe donacione për të huajt (OJQ-të);
6. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, dhe Menaxhimit të Kontratave dhe raporte për kërkesat e mos realizuara të Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2022;
7. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës për mbledhjen e radhës.

**Shënim:** në rast se drejtorët e drejtorive nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhjen e Komitetit për Komunitete lutem që të dërgojnë zëvendësit e tyre apo ndonjë zyrtarë kompetent.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:35*

*Mbledhja e radhës do të mbahet me d.t 13.02.2023.*

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit  
Dr. Mirsada Behluli

